



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15551 Prot.

Lezhë, më 31 . 08 .2020

VENDIM

Nr. 121 Datë 26 . 08 . 2020

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit Z.Tonin Martin Colaj, banor në fshatin Torovicë, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; të ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"; të VKM nr. 329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e pergatitur nga komisioni i ngritur, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z. Tonin Martin Colaj, banor në fshatin Torovicë, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, pas diskutimit të anëtareve, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Tonin Martin Colaj për dëmtimin e banesës së tij nga rënia e zjarrit.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në vlerën 45905 lekë.

a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë 9105 lekë.

b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 36800 lekë.

B. Mbështetur në VKM nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërma b e ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d, të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e Kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetë 4552 lekë.

b) Vlera e Kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje 36800 lekë.

Vlera totale 41352 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhe t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Tonin Martin Colaj, ndihmën emergjente në vlerën prej 41352 lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2020, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012 për Emergjencat Civile.
4. Ndihma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Z.Tonin Martin Colaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI

ERNEST RAKAJ

